

VENDIM
Nr. 3, datë 9.1.2019

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2019, TË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)

(ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 337, datë 22.5.2019)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2019, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, në shumën 50 249 000 (pesëdhjetë milionë e dyqind e dyzet e nëntë mijë) lekë, sipas pasqyrës nr. 1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ENTI RREGULLATOR I UJIT (ERRU)

Pasqyra nr. 1/1

PLANI I RISHIKUAR I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2019
(ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 337, datë 22.5.2019)

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2019 (lekë)
1.	Pagat dhe shtesat e tjera	32,447,000
2.	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	4,840,000
3.	Shërbime e furniturë	11,882,000
4.	Investime	1,080,000
	TOTALI	50,249,000